



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prilijena/Prodato Received/Delivery	24. 05 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shturca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	3006/2022		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.362/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.362/2022 të datës 13.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati

kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike-administrative "Transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 24.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.362/2022 të datës 13.04.2022, të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi përmes postës me datë 13.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 2048/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Gjakovës me rastin e ristrukturimit të nëpunësve të Gjendjes Civile dhe Sektorit për Inspektime ka bërë shkelje të ligjit material dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me rastin e transferimit të ankuesit nga pozita "Kurir" në pozitën "Zyrtar për Telefoni në sektorin për Siguri dhe Emergjencë" Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në Gjakovë .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 15.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje

në ankesë në Komunën e Gjakovës, ndërsa kjo e fundit me datë 28.04.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2472/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit të datës 13.04.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 31.03.2022; Vendimi i datës 15.03.2022; Akt emërimi i datës 12.03.2012; Flete lëshimi nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës; e-mail i datës 15.03.2022; Fletë dorëzimi i vendimit të datës 15.03.2022; Vendimi i datës 21.03.2022; e-mail i datës 21.03.2022, 23.03.2022; Propozimi i datës 28.03.2022; Vendimi i datës 31.03.2022; e-mail i datës 31.03.2022; Fletëdorëzimi i vendimit të datës 31.03.2022; Përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës së datës 28.04.2022 si dhe prova shtesë të datës 12.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi: *sepse:*

Ankuesi i punësuar në Komunën e Gjakovës në bazë të Akt Emërimit me numër 01-112-143/29 të datës 12.03.2012 në pozitën "Kurir i Zyrës së vendit Skivjan" në Drejtorinë për Punë të Përgjithshme Administrative, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër 01-112/02-8065 të datës 31.03.2022 lidhur me transferimin nga pozita "Kurir" në pozitën "Zyrtar për Telefoni".

Nga administrimi i provave të lëndës, është konstatuar se Komuna e Gjakovës, ka nxjerr vendimin me numër 01-112/02-6281 të datës 15.03.2022 me të cilin Sektori i gjendjes Civile dhe Sektori për Inspektime i nënshtrohet procedurës së ristrukturimit për shkak se janë ristrukturuar vendet e punës. Po ashtu me vendimin me numër 01-112/02-8065 të datës 31.03.2022 Menaxheri i Burimeve Njerëzore merr vendim me të cilin ankuesin e transferon nga pozita "Kurir" në pozitën "Zyrtar për Telefoni" në Sektorin për Siguri dhe Emergjencë, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 11.05.2022 përmes e-mailit zyrtar i është drejtuar DMZP-së me kërkesë që të përcillni listën për verifikimin e statusit të Zyrtareve Publik për Komunën e Gjakovës. Ndërsa me datën 12.05.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen nga ana e DMZP-se të cilët pozitën "Kurir" e kanë kategorizuar si pozitë të Nëpunësve Administrativ dhe Mbështetës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës* dhe se të punësuarit që kryejnë veprimtari ndihmëse dhe të mirëmbajtjes në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk i takojnë shërbimit civil respektivisht janë kategorizuar si nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës ashtu siç përcaktohet edhe me nenin 2 paragrafin 6 ku theksohet se: 6. *"Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës"*



*publike*", ka konstatuar se pozita "Kurir" të cilën pozitë ankuesi e ka në bazë të Akt Emërimit me numër 01-112-143/29 të datës 12.03.2012 hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit administrativ dhe mbështetës dhe nuk i përket pozitave të shërbimit civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.362/2022 të datës 13.04.2022, të parashtruar nga ankuesi

Në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon ankuesin se nëpunësi administrativ dhe mbështetës ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.362/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

  
Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

